

# ROLI I MEDIAS NË DIALOGUN NDËRFETAR NË SHQIPËRI

**Gentiana Skura**

Department of Journalist and Communication, UT, Tirana, Albania  
E-mail: gentaskura@gmail.com

## **Abstract**

Gjatë tranzicionit në Shqipëri ka pasur zhvillime shumë të rëndësishme në lidhje me zhvillimin e besimeve në Shqipëri. Po, ashtu edhe roli i medias ka qenë dhe vazhdon të jetë i rëndësishëm në prezantimin e tematikave me përmbajtje dhe ngjarje në lidhje me besimet fetare në vend. Duke shqyrtuar raste të rëndësishme përgjatë 2 dhjetëvjëçarëve të fundit do përpiqemi të nxjerrim në pah problematikën e komuniteteve fetare në vend si dhe paraqitjen nga ana e medias. Cdo ditë e më shumë roli i medias është domethënës në problematikën shoqërore. Por, jo gjithmonë gazetarët janë të kujdesshëm në lidhje me transmetimin e ngjarjeve me përmbajtje fetare. Është me interes të veçohen dhe analizohen disa raste, si në paraqitje e përmbajtje ashtu edhe nga respektimi i etikës. Nisur edhe nga ngjarjet e fundit, dëmtimi i ikonave në kishën e Shën Vlashit, vënia e më pas ndalimi i teatrit “Shën Mëria e Beratit”, të vënë në skenë nga trupa e teatrit të Korçës, pasqyrimin të konfliktit midis Kryepeshkopit Anastas Janullatos dhe priftit të Elbasanit, At Nikolla Markut; pasqyrimi në mediane dhe shkruar edhe atë online do na nxjerrë në përfundime interesante në lidhje me rolin e medias dhe ruajtjes së dialogut ndërfetar në Shqipëri. Në këtë kumtesë do të përdoret bibliografi e huaj dhe në gjuhën shqipe për dialogun ndërfetar, intervistat e marra përgjatë muajit shkurt, mars dhe prill të specialistëve të fushës në fjalë dhe kryeredaktorë të medias së shkruar. Por, rëndësi e veçantë do i kushtohet pikërisht analizës së medias në pasqyrimin e ngjarjeve të lidhura me komunitetet fetare.

***Fjalët kyçe:** dialogu ndërfetar, media në tranzicion, pasqyrim mediatik, etika e medias, objektiviteti i gazetarit, investigimi dhe kërkimi*